Aleksandar Biberaj gjatë karrierës së tij punoi në shumë vende. Që nga viti 2006 dhe tani punon në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, posti: Lektor, si dhe në Fakultetin e Teknologjisë të Universitetit Politeknik të Tiranës, Departamenti: Ekonomisë dhe Menaxhimit, Lektor, në të cilin në vitin 2009, kalon pedagog me kohë të plotë. Në periudhën e viteve 2009-2011, punoi në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Lektor. Në periudhën e viteve 2005-2009, punoi në Kuvendin e Shqipërisë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës dhe Komisioni i Integrimi, Deputet. Në vitet 2003-2005, punoi në Albanian Fiber Backbone, Fondi Shqiptaro-Amerikan i ndërmarrjeve, drejtues projekti. Në periudhën e viteve 1997-2003, punoi në Albtelecom Sh.a., Departamenti i Marketingut, specialist. Në vitet 1994-1997, punoi në Telekomin Shqiptar, Zv./Drejtori i përgjithshëm, anëtar i Këshillit Drejtues, Kryetar/Anëtar i Bordit Teknik, kurse gjatë viteve 1993-94, ishte në Televizionin shqiptar, inxhinier, Drejtor. Në vitet 1997-98, punoi në projektin FO Oxygen 2, Anëtar i Komitetit Drejtues, në vitet 1994-97, punoi në Adria 1, Trans Balkan line (TBL), Projekte ndërkombëtare me FO, Anëtar i Komitetit Drejtues, Anëtar i Nën-Komitetit Teknik, në të njëjtën periudhë ishte koordinator i Telekomit Shqiptar me Misionin Europian. Në periudhën e viteve 2005-2009, ishte deputet i Legjislaturës së XVII të Kuvendit të Shqipërisë, Anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financave dhe Anëtar i Komisionit të Integritit, në të njëjtën periudhë ishte në Asamblejën Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), Kryetar i Delegacionit Parlamentar Shqiptar në KE, Anëtar i Komitetit Politik dhe i Komitetit të Monitorimit. Në periudhën 2007-2009, ishte Zv. President i Asamblesë Parlamentare të KE-së, Zv. President i Grupit Parlamentar të Partive Popullore Europiane, në periudhën 2008-2009, ishte Zv. President i Komitetit të Rregullorës, Imuniteteve dhe Marrdhënieve Institucionale të KE-së dhe në periudhën e viteve 2008-2010, ishte reporter i KE-së: "denimi ndërkombëtar i Holodomor në Ukrainë si dhe i urisë masive në ish-territoret e tjera të BS të kryera nga regjimi i Stalinit në vitet 1930".

b) Veprimtaria botuese

Veprimtaria botuese e Aleksandar Bibiraj është e bujshme. Publikimet në revistat shkencore.

1. Privatizimi i telekomunikacioneve dhe rendësia strategjike e tij, Ekonomia dhe Biznesi, Tiranë, 2003.
2. Integration of Albanian Fiber Optic Network with project Oxygen 2, CRT Group Ltd, SHBA, 1997
3. Business management of Albanian Telecom in condition of monopol status, JICA, Japoni, 1997
4. New Technologies in Albanian Telekom Network, Sophia Antipolis Foundation, France, 1996
5. Telecom Development in Albania, Adam Smith Institute, Poloni, 1995
6. Operational Management in Albanian Telecom, SIDA, Suedi, 1995
7. Management of Human Resources in Albanian Telecom, Austri, 1995
8. New Management and New Leadership in Albania, Austria, 1994
9. Reforms in Albanian Telecom, Hungari, 1994.

Pos publikimeve, Aleksandar Bibiraj ishte aktiv në pjesëmarrje në Konferenca shkencore, në vend dhe jasht vendit, si dhe autor dhe koautor në disa monografi në gjuhën shqipe dhe në anglisht. Njeh këto gjuhë të huaja: Anglisht, frëngjisht, italisht dhe rusisht.

11. Behxhet Brajshori

a) Shkollimi

Behxhet Brajshori u lind më 11.08.1958. Ka të kryerë Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës në vitin 1982. Në të njëjtin fakultet dhe universitet vazhdoi studimet pasuniversitare dhe të disertacionit të doktoratës. Në vitin 1990 morri thirrjen shkencore magjistër i shkencave ekonomik, kurse në vitin 2009 mori thirrjen shkencore doktor i shkencave ekonomik, duke mbrojtë punimin me temë: "Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe i proceseve buxhetore".

b) Eksperienca në punë

Behxhet Brajshori gjatë karrierës së tij punoi në disa vende pune. Në periudhën e viteve 1983-90, punoi në Departamentin (Ministrinë) për Zhvillim dhe Planifikim Ekonomik, në postin: Bashkëpunëtorë i lartë shkencorë për energjetikë, metale me ngjyra dhe jometale (metaloide). Ndërkaq, në periudhën 1990-99, punoi në disa kompani private në: shërbime të kontabilitetit, shërbime të tatimeve, menaxhimi i zgjidhjeve, çështje financiare e buxhetore, rekrutimi dhe personeli, shërbimet e auditimit. Në periudhën e viteve 1999-2005, ishte i punësuar në Institutin Ekonomik të Kosovës, në postin: Hulumtues i pavarur në fushën e ekonomisë, kurse në vitet 2000-2001, punoi në Departamentin e Shërbimeve Publike-UNMIK, Shtylla II, në postin: Bashkëkryesues i Departamentit të Shërbimeve Publike, në periudhën 2002-2004, punoi në Ministrinë e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente, posti: Ministër, në kohën 2001-2007, punoi në Kuvendin e Kosovës, posti: Anëtarë i Kuvendit të Kosovës dhe anëtarë i Komitetit për buxhet dhe financa. Në periudhën kohore 2006-2007, ishte Zv. Ministër i Ekonomisë dhe Financave, në vitet 2008-2010, ishte Zv. Ministër në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në periudhën 2008-2009, ishte mësimdhënës në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë (UBT), në periudhën 2008-2009, ishte mësimdhënës në Universitetin "Universum", ku ishte bartës i lëndës: Politikat fiskale. Aktualisht është mësimdhënës në Universitetin Publik "Ukshin Hoti" në Prizren, në të cilin deri më 13 shkurt ishte Zv. Dekani i Fakultetit Ekonomik, udhëheqës i programit Master në trashigimi kulturore, udhëheqës i programit master në ekonomi në Fakultetin Ekonomik, anëtarë i grupit për sigurimin e cilësisë dhe bartës i lëndëve: Bazat e menaxhimit, ndërmarrësia dhe menaxhimi strategjik. Po ashtu, aktualisht punon në Kolegjin "FAMA", në postin e mësimdhënësit, në të cilin është bartës i këtyre lëndëve: Politikat publike, menaxhimi strategjik dhe ndryshimet organizacionale, financat publike. Që nga data 15.06.2015 dhe tani është anëtarë i Bordit Mbikqyrës në Bankën Qendrore të Kosovës.

c) Veprimtaria botuese

Behxhet Brajshori shumë aktiv në veprimtarinë publicistike. Ai botoi tekste universitare, punime shkencore në revistat shkencore në Kosovë dhe jashtë saj, mori pjesë aktive në Konferencat shkencore brenda dhe jashtë Kosovës dhe në projekte studimore.

A. Tekste universitare dhe punime shkencore

1. Shpenzimet publike, qëndrueshmëria buxhetore dhe vlerësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike në Kosovë, Universiteti i Bukureshtit, Revista "Manager", nr. 9/2009.

2. Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe i proceseve buxhetore (tekst universitar-fq.357), Universiteti "FAMA", 2010.
3. Ekonomia e Kosovës, Grup autorësh: Zhvillimi ekonomik i Kosovës që nga viti 1989 e këndeje, Monografi, 2010.
4. Zhvillimi i energjetikës si parakusht për zhvillimin ekonomik të Kosovës, "Ekonomia" nr. 3/1987, Instituti Ekonomik i Kosovës, 1987.
5. Humbjet dhe plaçkitjet në ekonominë e Kosovës pas vitit 1989, Studim, Instituti Ekonomik i Kosovës, 1990
6. Menaxhimi i shpenzimeve publike, Strategjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës, grup autorësh, ASHAK, 2002.
7. Njohurit bazë mbi politikat publike (tekst universitar-fq. 280), Rilindja, 2012.
8. Borxhi publik dhe menaxhimi i shpenzimeve, Revistë ndërkombëtare "DISKUTIME", nr. 7, Qendra për marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime balkanike-Tetovë dhe Instituti për studime evropiane i Univeristetit të Tiranës, 2013.
9. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, situata aktuale dhe sfidat e zhvillimit, Revista "DISKUTIME", Nr. 10, 2014
10. Norma e interest dhe metodat e kalkulimit të saj, Revista "DISKUTIME", nr. 12, 2014
11. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme-faktor kyç për zhvillimi ekonomik, Beyond the Horizon of Tempus Projects. Theory and Practice of Project Management, 2014
12. Financat publike, (tekst universitar-fq. 403), Universiteti Publik "Ukshin Hoti" në Prizren, 2014

B. Pjesëmarrje aktive në Konferenca shkencore

1. Status ii padefinuar i suverenitetit të Kosovës-Barrierë për investime të jashtme, Konferenca e katërt ndërkombëtasre mbi politikat dhe sistemet e informacionit, teknologjit dhe aplikacionet, Fevista (PISTA), 2006,
2. Ndikimi i politikës fiskale në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e punësimit, Konferenca e gjashtë ndërkombëtare "Biznesi dhe punësimi, "Biznesi dhe punësimi, IFK, Prishtinë, 2007
3. Energjia dhe linjiti në Kosovë, Konferenca ndërkombëtare "Investimet në rajon, Stamboll, 2007,
4. Të arriturat dhe sfidat në menaxhimin e financave pulike në Kosovë, Konferenca e 21 vjetore e ICGFM mbi "Vlerësimi it ë arriturave dhe zbgulimi i mudnësive-Ndërtimi i një kornize të fortë financiare të menaxhimit, Revista ICGFM, 2007
5. Zhvillimi ekonomik dhe financiarë në Kosovë dhe kriza globale, Konferenca e ICGFM "Perspektivat vendore mbi menaxhimin e financave puiblike gjatë pasigurisë së ekonomisë globale, Revista ICGFM, 2009.
- 6.

D) Projektet nftkombtëtare

1. Tempus project 517482-Tempus -1-2011-Detempus-JPR, Osnabrueck, Unif, of AS, University of Applied Science, 2012
2. Tempus project, Network for Post Graduate masters in Cultural Heritage and Toursim Mangement in Balkan. Counties (CHTAMBAL)-Workshps and stydy visists in University of Chieti, Roma, Bololnja, Rimini, Italy, prill, 2012
3. Tempus project, Network for Post Graduate masters in Cultural Heritage and Toursim Mangement in Balkan. Counties (CHTAMBAL)-Workshps and study visists in University of Rimini, Italy, prill, 2013
4. Konferenca ndërkoambëtare shkencore "Shtresa e mesme dhe mjedisi, Bullgari, Plovdiv, maj 2013
5. Tempus project: Quality assyrance-Tempus Projest 517482-1-2011, qershor, Prishtinw, 2013

III. Mendimi dhe propozimi

Duke u bazuar në të dhënat e materialit të disponueshëm të ofruar nga administrata e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, thirrjeve, punës akademike dhe publikimeve, kriteret e konkursit nga ata që kanë aplikuar i plotësojnë vetëm Naim Mustafa, Bashkim Bellaqa, Aleksandar Biberaj dhe Behxhet Brajshori, të cilët kanë bazë formale-juridike dhe profesionale-shkencore, për angazhim në lëndët: Ndërmarrësi dhe Bazat e menaxhimit, kuptohet me disa elemente dalluese.

Dr. Nami Mustafa, ka thirrjen profesor asistent, përvojë shumë vjeçare në arsimin superior, punime shkencore e profesionale, që në pikëpamje formale i plotëson kushtet sipas konkursit të pranohet në lëndët: Ndërmarrësi dhe bazat e menaxhmentit.

Dr. Bashkim Bellaqa, ka thirrjen profesor asistent, ka pakë përvojë në procesin e arsimit superior, punimet shkencore nuk janë të përafërta me tematikën dhe fushën e lëndëve: Ndërmarrësia dhe Bazat e menaxhmentit.

Dr. Aleksanda Biberaj, ka thirrjen profesor i asocuar, përvojë të punës kryesisht jashtë procesit të arsimit superior, punimet e publikuara shkencore e profesionale, po ashtu janë kryesisht nga fusha e teknologjisë dhe informatikës, e shumë largë nga lëndët në të cilat konkuron për mësimdhënës.

Dr. Behxhet Brajshori, ka thirrjen profesor i asistent, të cilën e mori më 19.09.2011. Ka përvojë të gjatë në arsimin superior ku ka ligjeruar në disa Universitete publike e Kolegje private

në Kosovë. Ka të botuara disa tekste universitare, monografi dhe shumë punime të botuara shkencore në revistat shkencore në Kosovë dhe jashtë saj, shumë punime profesionale dhe pjesëmarrje aktive në Konferenca shkencore dhe disa projekte profesionale. Andaj, duke u bazuar në përvojën në arsimin superior, tekstet e botuara, punimet e publikuara shkencore, punimet profesionale etj. na japin me konstatuar se Dr. Behxhet Brajshori, është shumë më superior se aplikantët e tjerë për mësimdhënës në lëndët: Ndërmarrësia dhe Bazat e menaxhimit.

Andaj, duke pasur parasysh anën profesionale-shkencore, veçmas pedagogjike, tekstet e botuara universitare, punimet e botuara shkencore në revistat vendore dhe të jashtme, punimet profesionale, marrja pjesë aktive në Konferenca e projekte shkencore, përvojën shumë vjeçare në procesin e arsimit superior, në anëtarët e Komisionit recenzues, kemi ndërën dhe kënaqësinë që Këshillimit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, t'i propozojmë që Z. Behxhet Brajshorin ta zgjedhë mësimdhënës në lëndët: Ndërmarrësi dhe Bazat e menaxhimit. Njëherit, duke u mbëtetur në nenin 172, al. 1, pika 1.1., 1.2., 1.3., 1.4., dhe 1,5. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ku parashihen kriteret dhe kushtet për avancim në gradën akademike profesor i asocuar, të cilat i plotëson kandidati Dr. Behxhet Brajshori, Komisioni recenzues i propozon Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren që Dr. Behxhet Brajshorin ta avancojë në thirrjen akademike profesor i asocuar për lëndët: Ndërmarrësi dhe Bazat e menaxhimit.

Prizren, më 22.09.2015

Anëtarët e Komisionit,

1. Dr. Musa Limani, profesor i rregullt, kryetar
2. Dr. Justina Pula, profesor i rregullt, anëtar
3. Dr. Ymer Havolli, profesor i asocuar, anëtar



 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universiteti Prizreni "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 02.10.2015	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	02-316/0

Në bazë të vendimit nr. 01-361, dt. 11.09.2015, jemi caktuar në Komisionin recensues lidhur me vlerësimin e dokumentacionit të aplikantëve që kanë konkurruar për Mësimdhënës në Konkursin e publikuar nga UPZ-ja, për stafin akademik, me nr. ref. 01-289, dt. 31.07.2015, për vitin akademik 2015/2016, për lëndët: Makroekonomi dhe Financat Ndërkombëtare. Komisioni recensues ka këtë përbërëje:

1. Prof. Dr. Musa Limani, kryetar,
2. Prof. Dr. Mujë Gjonbalaj, anëtar,
3. Prof. Dr. Rustem Asllanaj, anëtar.

Në bazë të dokumentacionit që ka ofruar administrata e Universitetit Publik "Ukshin Hoti" në Prizren, japim këtë:

R A P O R T

Duke u bazuar në materialin që disponojmë dhe në bazë të konkursit të shpallur, për lëndët: Makroekonomi dhe Financa Ndërkombëtare, kanë konkurruar këta kandidat:

1. Seadin Xhaferi
2. Agim Berisha
3. Gani Gjini
4. Jehona Shkodra
5. Sinan Ademaj
6. Ibrahim Kryeziu

I. Biografite

Në vazhdim po i prezantojmë biografitë e shkurtëra të kandidatëve që kanë aplikuar në lëndët: Makroekonomi dhe Financa Ndërkombëtare, në bazë të konkursit të shpallur më dt. 31.07.2015.

1. Seadin Xhaferi.

a) Shkollimi

Seadin Xhaferi u lind më 24.05.1953 në fshatin Zajas komuna e Kërçovës Republika e Maqedonisë, i cili ka dhe shtetësinë e Republikës së Kosovë, aktualisht jeton në Tetovë. Në vitin akademik 1975/80, kreu Fakultetin Teknologjiko-Metalurgjik në Universitetin "Shën Kiril e Metodij" në Shkup. Në vitin akademik 2000/2003, në Universitetin "Sh. Kiril e Metoldij", Instituti i Ekonomisë, mori thirrjen magjistër i shkencave ekonomike, duke mbrojtur punimin

me temë: "Investimet e huaja në ekonomin e Republikës së Maqedonisë. Në vitin akademik 2003/2005, ka doktoruar në Universitetin "Sh. Kiril e Metodij", Instituti i Ekonomisë, duke mbrojtur punimin e disertacionit të doktoratës me temë: "Potenciali financiar i mërgimtarëve dhe kyqja e tij në ekonomin e Republikës së Maqedonisë".

b) Eksperienca në punë.

Seadin Xhaferi, gjatë karrierës së tij punoi në shumë vende, veçmas në institucionet të arsimit superior në Maqedoni dhe jashtë saj. Në mars të vitit 2015 u zgjodh Shef i Departamentit Financa dhe Kontabilitet në Universitetin Shtetëror të Tetovës (USHT). Që nga tetori i vitit 2006 e këndej, u punësua në USHT-vës, në të cilin mbajti këto lëndë:

- a) Në studimet bachelor: Menaxhimi i investimeve, Menaxhimi financiar, Financa ndërkombëtare, Menaxhimi i burimeve njerëzore.
- b) Në studimet master: Menaxhimi i investimeve dhe financave, Menaxhimi financiar ndërkombëtar, Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore.

Në periudhën 2008/2010, ishte zëvendës dekan i Fakultetit Ekonomik në USHT, kurse në periudhën e viteve 2010/2012, ishte koordinator i studimeve master në USHT. Ndërkaq, në periudhën e viteve 2004/2006, ishte profesor i angazhuar në USHT, në të cilin ishte bartës i lëndëve: Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe Menaxhimi i sjelljes organizative. Në periudhën 2008/2013, ishte profesor në USHT dhe në Universitetin e Evropës Juglindore, në të cilët ishte bartës i këtyre lëndëve: Menaxher financiar, Financat e korporatave, Menaxhimi i investimeve, Biznes ndërkombëtar, Financat publike, Ekonomi monetare, Menaxhim financiar ndërkombëtar, Menaxhimi i burimeve njerëzore. Madje, në periudhën e viteve 2000/2006, punoi në Qeverinë e Maqedonisë në "Agjencionin e migracionit" në Shkup, në cilsinë e Zëvendës drejtorit, ndërkaq në periudhën e viteve 1998/2001, në Ministrinë e migracionit ishte ndihmës ministër në Qeverinë e Maqedonisë. Në vitet 1996/1998, punoi në shkollën e mesme "Goce Stojçeski" në Tetovë, në postin: Zëvendës drejtor, kurse në periudhën e viteve 1993/96, në të njëjtën shkollë ishte profesor. Në periudhën e viteve 1989/1993, ishte përfaqësues i firmës "Bauer Enzler AG" të Zvicrës në postin: Menaxher i burimeve njerëzore, kurse në periudhën e viteve 1981/1989, punoi në Universitetin "Shën Kiril e Metodij" Fakulteti Teknologjiko-Metalurgjik në Shkup, në postin: Bashkëpunor profesional.

Seadin Xhaferi, pos vendeve të punës të sipër cekura, ishte anëtar i këtyre institucioneve:

- Në vitin 2005, ishte themeluar dhe anëtar i bordit të "Qendrës për migrime dhe zhvillim", në Shkup,



- Në vitin 2004, ishte anëtar i komitetit në projektin AMBO, projekt i Ministrisë së Ekonomisë dhe anëtar i Komitetit nacional për energji në Ministrinë e Ekonomisë në Shkup,
- Në periudhën e viteve 2004-2014, ishte kryetar i Komisionit për informim dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Kryqin e Kuq të R. së Maqedonisë në Shkup
- Në vitin 2002, ishte hulumtues në "Qendrën për banka dhe financa" në Shkup,
- Në vitin 2000, ishte antër i Bordit profesional në "Qendrën për zhvillim të qendrueshëm" në Shkup,
- Në periudhën e viteve 2006-2007, ishte anëtar i timit punues në projektin: "Strategjia për zhvillimin e industrisë së tekstilit: në R. e Maqedonisë,
- Në periudhën e viteve 1998-2000, ishte pjesëmarrës në projektin: "Human resources management, Public administration raefrom projekt.

c) Veprimtaria botuese.

Seadin Xhaferi, është mjaft produktiv edhe në veprimtarinë botuese. Deri më tani ka të botuara këto tekste universitare:

- a) Paraja, banka dhe kredit, Prishtinë, 2015
- b) Financa ndërkombëtare, Tetovë, 2013,
- c) Menaxhbimi i burimeve njerëzore-cikël leksikonesh, USHT, 2012,
- d) Menaxhimi financiar-cikël leksikonesh, USHT, 2011,
- e) "Terminologji financiaare", Interlingua, Shkup, 2009,
- f) "Menaxhimi i investimeve", Interlungua, Shkup, 2007,
- g) Leksikon i vogël i Financave dhe Ekonomisë ndërkombëtare, Interlingua, Shkup, 2006
- h) Manuel për Financa publike, ARPEPLA, 2006,
- i) Kapitali financiar i mërgimtarëve dhe përfshirja e tyre në ekonominë e R. së Maqedonisë, Interlingua, Shkup, 2005
- j) "Emigracioni nga Maqedonia Perëndimore në Rumani", Interlingua, Shkup, 2004.

Pos teksteve të sipër cekura, Seadin Xhaferi, ka një numër të konsiderueshëm të punimeve shkencore (gjithsej 11), të botuara në revistat shkencore në Maqedoni, Kosovë, Shqipëri dhe në vendet e tjera, kryesisht në gjuhën angleze, dhe, punime profesionale dhe paraqitje kumtesash në Konferenca vendore dhe ndërkombëtare mbi 27 sosh.

Në karrierën e tij, Seadin Xhaferi ka kryerë edhe disa specializime, siç janë:

- Në vitin 2009, ka specializuar për Organizimin e studimeve të ciklit të tretë dhe ngritjen e cilsisë gjatë hulumtimeve, në Universitetin e Stafoldrshirit, Universitetin e Tirnaës dhe në Universitetin Shtetror të Tetovësë,

- Në vitin 2007, specializoi për ngritjen e cilësisë së mësimdhëniesë dhe hartimit të programeve studimore në Angli Universiteti i Stafordshirit,
- Në vitin 2006, specializoi për avancimin e kurikuleve studimore në Suedi Universiteti i Vekshes, në të njëjtin vit kreu edhe kursin intensive të gjuhës nagleze dhe hartimin e kurikuleve.
- Seadin Xhaferi njeh këto gjuhë të huaja: Maqedonishtën, serbo-kroatishtën, anglishtën, dhe gjermanishtën

2. Agim Berisha

a) Shkollimi

Agim Berisha u lind më 15.12.1973 në fshatin Đejnë, Komuna e Rahovecit. Ka të kryerë Fakultetin Ekonomik të Universiteti të Prishtinës, Drejtimi: Banka dhe financa. Studimet pasuniversitare, po ashtu i ka kryerë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në të cilin magjistroi në vitin 2007, ndërsa studimet e disertacionit të doktoratës i ka kryerë në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në Drejtimin: Financë-Kontabilitet. Tema e disertacionit: *"Ndërtimi i sistemit fiskal dhe ndikimi i tij në ekonominë e Republikës së Kosovës"*, e mbrojtur më 19.12.2013.

b) Eksperienca në punë.

Që nga fillimi dhe aktualisht punon në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pozitën: Auditor i brendshëm.

c) Punime dhe publikime

Agim Berisha, është aktiv edhe në veprimtarinë botuese publicistike. Deri më tani ka të botuara 15 punime shkencore të botuar në revistat shkenocre të Kosovës dhe jashtë saj dhe ka marrë pjesë në 10 Konferenca ndërkombëtare dhe kombëtare.

3. Gani Gjini

a) Shkollimi

Gani Gjini u lind më 29.01.1954 në fshatin Bresanë, komuna e Dragashit (Sharrit). Ka të kryerë Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës. Studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin Ekonomik, Drejtimi: Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare, në Universitetin e Zagrebit. Thirrjen magjistër i shkencave ekonomike e mori në vitin 1987 duke mbrojtur punimin me temë: “.Viši oblici privredne suradnje s inozemstvom kao mogućnost za povećanje korišćenja kapaciteta i počećanje izvoza i uvoza sap Kosova” ne Universitetin e Zagrebit Fakulteti Ekonomik-Zagreb, Ndërkaq, thirrjen akademike doktor i shkencave ekonomike e mori në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, në vitin 2003, duke mbrojtur punimin me temë: “Tregtia e jashtme si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës”. Thirrjen akademike profesor asistent e mori më 23.09.2011.

b) Eksperienca në punë

Gani Gjini, gjatë karrierës së tij punoi në disa vende pune në ekonomi dhe në arsim. Kështu, në periudhën 05.01.1981-15.12.1985, punoi në ndërmarrjen IFS “Progres” në Prizren, në postin Menaxher në sektorin e eksport-importit, në periudhën 15.02.1985-21.04.1991, ishte i punësuar në ndërmarrjen ndërtimore “ELAN” në Prizren, në postin udhëheqës i Shërbimit Komercial.

Gani Gjini, një periudhë të gjatë kohore punoi dhe tani punon në arsimin superior. Kështu, në vitin akademik 2006-2007, ishte mësimmhdhënës në Kolegjin Universitar “FAMA” në Prizren, ku mbajtin lëndën: Ekonomia e resurseve., në vitin akademik 2007-2008, ishte mësimmhdhënës në Kolegjin Universitar “UNIVERSUM” në Prishtinë, ku mbajti lëndët: Biznes ndërkombëtar dhe Institucionet financiare ndërkombëtare, kurse në vitin akademik 2008-2009, mbajti lëndën: Biznesi ndërkombëtar. Në këtë Kolegj dega në Ferizaj, në vitin akademik 2009-2010, mbajti lëndën: Integrimet ekonomike evropiane. Në vitin akademik 2008-2009, ishte mësimmhdhënës në Universitetin “DARDANIA” në Prishtinë, ku mbajti lëndët: Tregu financiar dhe institucionet financiare dhe Ekonomia e sigurimeve. Në vitin akademik 2011-2012, ishte mësimmhdhënës në Universitetin Internacional në Strugë, ku në studimet pasuniversitare ligjëroi lëndët: Tregtia e jashtme dhe doganat. Në vitin akademik 2012-2013, ishte mësimmhdhënës në Kolegjin “BIZNESI” në Prizren, ku mbajti lëndët: Marketing dhe ndërmarrësi.

Gani Gjini, duke filluar nga viti akademik 2010-2015, punoi dhe aktualisht është i punësuar në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren. Gjatë kësaj periudhe në këtë Universitet

ligjeroi këto lëndë: Biznesi ndërkombëtar, Makroekonomi, hyrje në ekonomi të biznesit, ekonomia e aplikuar, tregtia e jashtme, në bachelor, kurse në master ka mbajtur këto lëndë: Marketingu në turizëm, ekonomiksi menaxherial.

Gani Gjini, është kordinator i projektit "Strategjia e zgjerimit dhe sigurimit të cilësisë për Universitetin e Prizrenit, i cili është i financuar me përkrahjen e Komisionit Evropian dhe kordinator te projekti i "Tempusit" "Increasing the Financial Autonomy and aecountablity at public Higher", education Institutions in Kosovo (FAITH).

Gani Gjini që nga data 09.02.2015, është ushtrues detyre i Dekanit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.

Gani Gjini njih këto gjuhë të huaja: serbo-kroatishten, gjuhen angleze dhe turke.

c) Veprimtaria botuese

Gani Gjini, pos procesit mësimor është aktiv edhe në veprimtarin botese. Deri më tani ka të botuara këto tekste, dispenca dhe publikime shkencore:

1. Tregtia e jashtme si faktor i zhvillimit ekonomik të Kosovës (Monografi), Prizren, 2005,
2. Ekonomia e resurseve (dispencë), Prizren, 2007
3. Sfidat e Integritimit Evropian per Ballkanin Perendimore, Universum Journal, Reviste Shkencore 2008
4. European perspective of Balkans, i botuar në: "Karadeniz arastirmalari", Turqi, 2007,
5. Proces Stabilizacije i assosacije kao politika EU-ja za Zapadni Balkan, Univerzitetsko misao, Novi Pazar, 2009. INTERNACIONALNI UNIVERZITET U NOVOM PAZARU, Časopis za nauku, kluturu i umjetnost.
6. Struktura Ekonomike dhe Tranzicioni ne Kosove, Reviste nderkombetare "DISKUTIME" Nr.15 Qendra per mardhenie nderkombetare dhe studime ballkanike – Tetove dhe Instituri per studime evropiane i Universitetit te Tiranës, 2015
7. Maketingu në turizëm (dispencë), Prizren,
8. Financat ndërkombëtasre (tekst universitar), Prizren, 2015

4. Jehona Shkodra

Kërkesës së saj ia ka bashkangjitur vetëm CV, e cila është vetëm në gjuhën angleze, pa kurrfarë dokumentacioni tjetër. Pa dokumentacion komplet nuk mund të konstatohet niveli arsimor, si dhe punimet e publikuara. Për këtë arsye nuk është marrë në konsiderat shqyrtimi i kërkesës së saj, nga ana e Komisionit recenzues.

9. **Sinan Ademaj**, ka heqë dorë nga konkursi

10. **Ibrahim Kryeziu**

a) **Shkollimi**

Ibrahim Kryeziu i lindur më 06.11.1960 në fshatin Xerxë, Komuna e Rahovecit. Ka të kryerë Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës, Në vitin 2013 merrë thirrjen master i shkencave ekonomike, Tani është kandidat për doktorat në Fakultetin Ekonomik të Universitetit Evropian të Tiranës.

b) **Eksperiencia në punë**

Shkurt 2015-qershor 2015, ishte ligjerues në Fakultetin Ekonomik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ku kam mbajtur lëndën: Menaxdhimi ndërkombëtar. Në kohën korrik 2009-janar 2011, ishte i punësuar në Ekspert lokal-Konsultant për qeverisjen locale në Komunën e Junikur, maj 2011-maj 2012, ishte Konsultatn për zvillim ekonomik lokal në këtë komunë, kurse, në kohën prill 2013-maj 2014, ishte Konsultant-Këshilltar për qeverisje lokale në njëjtën komunë. Nw periudhwn e viteve tetor 2008-qershor 2009, ishte ekspert i qeverisjes lokale nw komunwn e Suharekws dhe nw periudhwn 05.02.2003-31.12.2007, ishte Kryeshef Ekzekutiv i Komunws sw Rahovecit.

c) **Veprimtaria botuese**

Në bazë të dokumentacionit që disponon Komisioni, deri më tani nuk ka asnjë punim të publikuar

II. Mendimi dhe propozimi

Duke u bazuar nga të dhënat e materialit të disponueshëm të ofruar nga administrate e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, thirrjeve, punës akademike dhe publikimeve, Kriteret e konkursit nga aplikantët që kanë aplikuar për mësimdhënës në lëndët: Financat ndërkombëtare

dhe Makroekonomi, i plotësojnë vetëm Seadin Xhaferi, Agim Berisha dhe Gani Gjini, të cilët kanë bazë formale-juridike dhe profesionale-shkencore, kuptohet me disa elemente dalluese.

Dr. Seadin Xhaferi, ka thirrjen e profesorit të rregulltë. Që në fillim duhet potencuar se S. Xhaferi nuk e ka të kryerë fakultetin ekonomik, por nga kjo fushë ka thirrjet adekuate shkencore e akademike, përvojë pedagogjike, punime shkencore etj., por ka moshën (62 vjet) dhe nuk jeton në Kosovë, që paraqet problem çështja e udhimit dhe mungesa e prezencës së përditshme në Universitet, e që është problem në vete për kontaktin e studentëve me pedagogun për konsultime dhe çështje të tjera rreth procesit mësimor. Dr. Agim Berisha, ka thirrjen akademike profesor asistent, është ekonomist dhe pedagog i njohur, i respektuar te studentët dhe stafi akademik. Fushë specializimi më të afërt ka makroekonominë dhe politikën fiskale.

Dr. Gani Gjini, ka thirrjen profesor asistent, në të cilën u avancuar më 23.09. 2011. Gani Gjini ka përvojë të gjatë në ekonomi dhe veçmas në arsimin superior. Pas vehte ka një përvojë të madhe pedagogjike dhe profesionale-shkencore. Ka punuar në disa Universitete e Kolegje, në të cilat ishte bartës i shumë lëndëve ekonomike, por më të theksuara ishin lëndët: Financat ndërkombëtare, Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, Makroekonomia etj. Tani është në marrëdhënie të rregulltë pune në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe mban postin e Ushtruesit të Dekanit të Fakultetit Ekonomik të këtij universiteti. Është i lindur dhe jeton në Prizren. Nga aplikantët e tjerë, Gani Gjini më së miri i plotëson kushtet sipas konkursit që të zgjedhet mësimdhënës në lëndët: Financa ndërkombëtare dhe makroekonomi. Andaj, duke pasur parasysh anën profesionale-shkencore, veçmas pedagogjike, tekstet e botuara universitare, punimet shkencore e profesionale, përvojën shumë vjeçare në procesin mësimor të arsimit të lartë, përvojën organizative e menaxhuese, ne anëtarët e Komisionit recenzues, kemi nderin dhe kënaqësin që Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, t'i propozojmë që z. Gani Gjini ta zgjedh mësimdhënës në lëndët: Financat ndërkombëtare dhe Makroekonomi. Po ashtu, duke u bazuar në nenin 172, alenia 1, pikat 1.1.,1.2, 1.3, 1.4, dhe 1.5. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, ku parashihen kushtet dhe kriteret për avancim në thirrje akademike profesor i asocuar, të cilat i plotëson Dr. Gani Gjini, Komisioni recenzues i propozon Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, që Dr. Gani Gjiniin ta avancojnë thirrjen profesor i asocuar në lëndët: Financat ndërkombëtare dhe Makroekonomi.


Prizren, më 22.09.2015

Anëtarët e Komisionit,



1. Dr. Musa Limani, profesor i rregullt, kryetar
2. Dr. Mujë Gjombalaj, profesor i rregullt, anëtar
3. Dr. Rustem Asllani, profesor i asocuar, anëtar





RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Raporti i recensionit

Fakulteti i Ekonomisë, Prizren

Lënda: **Gjuhë angleze I dhe II**

Kandidatet: dr.sc. Jusuf Mustafa, mr.sc. Myrteza Muriçi, mr.sc. Memidin Braha, mr.sc. Elvir Shtavica dhe mr.sc. Mirlinda Vula.

Të dhënat për kandidatin e parë:

Emri dhe mbiemri: **Jusuf Mustafa**

Datëlindja dhe vendlindja: 26.02.1969

Gradat shkencore: Profesor i gjuhës dhe letërsisë angleze (Fakulteti Shkencave Humane dhe Arteve, Tetovë, nr. 09333-1/95. **Nuk ka barazëvlerësim** nga MASHT-i), Diplomë e Studimeve të Thelluara Pasuniversitare (*Magjistër i gjuhës dhe Letërsisë Angleze*, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Departamenti i Gjuhës Angleze, Tiranë, **Nuk ka barazëvlerësim** nga MASHT-i). Doktor i Shkencave Filologjike (në Universitetin e "Sv.Kirili i Metodij" Fakulteti i Filologjisë, Shkup, nr. 3243, barazëvlerësimi nga MASHT-i nr.6-236).

Titujt akademik: Profesor asistent, Nr.152/13

Viti kur është fituar titulli aktual: 2013

Fakulteti/Departamenti: Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup

Mbështetur në kriteret e konkursit publik nr.01-289, i cili ka paraparë, si: "*Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar ose që kanë mbaruar **master jashtë vendit**, duhet të sjellin edhe dëshmi për **nostrifikimin** e diplomës përkatëse nga MASHT, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar*".

Kandidati ka ofruar dëshmi se ka diplomuar (studimet themelore) në Fakultetin e Filologjisë në Tetovë, mirëpo për fat të keq nuk kemi parë se në dosjen e tij ka nostrifikim. Gjithashtu

edhe për studimet pasuniversitare, kandidati ka dëshmuar se ka mbaruar në Fakulteti i Gjuhëve të Huaja në Tiranë, por **Nuk ka barazëvlerësim** nga MASHT-i. Kandidati ka dëshmuar se ka mbaruar doktoraturën dhe është Doktor i Shkencave Filologjike (në Universitetin e "Sv.Kirili i Metodij" Fakulteti i Filologjisë, Shkup, barazëvlerësimi nga MASHT-i nr. 6/4-236).

Kandidati ka mjaft punime shkencore të botuara si autor dhe bashkëautor, i cili i ka publikuar në revista të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Kandidati ka disa vite përvojë punë në Universitetin e Tetovës, Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Prizrenit dhe në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.


Duke ju referuar kritereve të konkursit publik të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit dhe mbështetur në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, nenet 171-173 dhe në kriteret e konkursit publik **nr.01-289** të datës **31.07.2015**, kandidati z Jusuf Mustafa **nuk** i plotëson kushtet juridike për t'u propozuar për mësimdhënës. **REFUZOHET**.

Kandidatet e tjerë:

Duke ju referuar kritereve të konkursit publik të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit dhe mbështetur në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, nenet 171-173 dhe në kriteret e konkursit publik **nr. 01-289** të datës **31.07.2015**, kandidatet, **mr.sc. Myrteza Muriçi mr.sc.Memidin Braha, mr.sc. Elvir Shtavica dhe mr.sc. Mirlinda Vula nuk** i plotësojnë kushtet juridike për t'u propozuar për mësimdhënës. **REFUZOHEN**.

Nënshkrimet e Komisionit recensues:


1. Kryetar Prof.ass.dr.Sadete Pllana



2. Anëtar Prof.dr.Vedat Kiseri



3. Anëtar Prof.ass.dr. Shkelqim Millaku



Prizren, më 10.09.2015

